

Në bazë të nenit 37 – nj dhe 37 – n të Ligjit për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 39/16 dhe 64/18), nenit 20–23 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit publik për punësim dhe konkursit intern për avancime, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për punësime dhe avancime, mënyrën e realizimit të përzgjedhjes për punësime dhe avancime, si dhe mënyrën e vlerësimit me pika për ofruesit e shërbimeve publike 02-1194/11 të datës 22.06.2017, U.D. Drejtor i NP “Parqe dhe gjelbërime” shpall:

KONKURS INTERN me nr. 04/2018

për plotësimin e vendit të punës përmes avancimit

Nr..	Vendi i punës	Sektori	Seksioni	Shifra	Nr. i realizu esve
1.	Këshilltarë i drejtorit për Gjelbërimin Urban			KDR0305A01084	1

1. **KËSHILLTAR I DREJTORIT PËR GJELBËRIMIN URBAN**, shifra KDR0305A01084, (1) një realizues.

- ***Kushte të përgjithshme***

- të jetë nënshtruar i Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive të shfrytëzojë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës së pjekur;
- të posedojë aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

- ***Kushte të posaçme***

- Së paku 240 kredi të fituara sipas EKTS ose të përfunduar nivelin VII/1;

(Pyltari dhe hortikulturë, Prodhimtari e bimëve, Shkenca për truallin dhe hidrologji).

- Për nivelin A1 së paku katër vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku dy vite në vende udhëheqëse pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku tre vite në vendin udhëheqës në sektorin privat;
- Njohja aktive e programeve kompjuterike për punën në zyra, përmes ofrimit të vërtetimit;
- Njohjen e njërës prej tre gjuhëve më shpesh të shfrytëzuara në Bashkimin Evropian, përmes ofrimit të vërtetimit.

- **Kompetenca të përgjithshme të nevojshme lidhur me nivelet A:**
 - Të posedoj kualifikime përkatëse profesionale për vendin e punës;
 - Të posedoj përvojën e punës, që nevojitet për vendin e punës dhe
 - Të posedoj kompetenca të posaçme punuese që nevojiten për këtë vend pune.
- **Përcaktimi i orarit të punës:**
 - Ditët e punës : e hënë – e premte, nga 07:00 – 15:00;
 - Orët e angazhimit punues në javë 40 orë.
- Shuma e neto pagës është: 36.015,00 denarë.

Në konkursin intern mund të paraqiten të gjithë të punësuarit nga ndërmarrja të cilët i përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara për vendin përkatës të punës, në pajtim me rregullores për sistematizim të vendeve të punës në suaza të ndërmarrjes.

Afati i parashtrimit të fletëparaqitjeve është 5 (pesë) ditë, llogaritur nga dita e shpalljes së konkursit.

Kandidatët e interesuar, duhet të parashtojnë fletëparaqitjen e plotësuar dhe dëshmitë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, përmes arkivit të NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup deri te Seksioni për menaxhim me resurset njerëzore, në adresën NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, bul. Ilinden nr. 104, si dhe deri te adresa zyrtare elektronike covecki.resursi@parkovi.com.mk me shenjën “për konkursin intern” .

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të plotësuar në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

Procedurën do ta realizojë Komisioni për përzgjedhje për avancime, i formuar nga ana e Drejtorit të NP “Parqe dhe gjelbërime” - Shkup.

VËREJTJE: Kandidati i cili ka parashtruar të dhëna të rreme do të diskualifikohet nga procedura e mëtutjeshme.

NP “Parqe dhe gjelbërime”

UD Drejtor

Ardijan Muça